

NARRATIVAT TOKSIKE

HESHTJA E TË
SHPREHURIT
NË BALLKANIN
PERËNDIMOR

pen
INTERNATIONAL

Autore: prof.dr. Leila Turçia dhe prof.dr Belma Bulubashiq

Redaktore: Aurélia Dondo

Përkthyes: Goran Drinçiq

Dizajni: Brett Evans Biedscheid

Mirënjohje për: PEN Bosnjë-Hercegovina, PEN Kosova,
PEN Qendra Malazeze dhe PEN-i Serb

Botuar nga PEN International më 2023 me
mbështetjen e Fritt Ord Foundation.

PEN International promovon letërsinë dhe lirinë e shprehjes. Udhëhiqet nga Karta e PEN-it dhe parimet e saj: komunikimi i papenguar i mendimit përbrenda secilit komb dhe mes të gjitha kombeve. I themeluar më 1921, PEN International ndërlidh komunitetin ndërkombëtar të shkrimtarëve nga Sekretariati i tij në Londër. Është forum ku shkrimtarët takohen lirshëm për të diskutuar punën e tyre; është po ashtu një zë që flet për shkrimtarët e heshtur në vendet e tyre. Nëpërmjet Qendrave në mbi 140 vende, PEN-i operon në pesë kontinente. PEN International është organizatë jo-politike që ka Status special konsultativ në OKB dhe Status bashkëpunëtor në UNESCO.

PEN International është e regjistruar si organizatë bamirëse në Angli dhe Uells me numër regjistrimi 1117088.

pen-international.org

- 1 PARATHËNIE
- 3 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
- 4 GJETJET KYÇE
- 5 SFONDI
- 6 METODOLOGJIA
- 7 LIRIA E SHPREHJES NË RAJONIN E BALLKANIT
PERËNDIMOR: VËSHTRIM
- 8 BOSNJË-HERCEGOVINA
- 10 KOSOVË
- 11 MALI I ZI
- 13 SERBIA
- 15 ANALIZË KRAHASUESE
- 15 KORNIZAT LIGJORE DHE ZBATIMI
- 16 SH TREMBËRIMI I SË KALUARËS SË AFËRT NXIT
AGJENDA POLITIKE PËRÇARËSE DHE
RETORIKË NACIONALISTË
- 17 FUSHATAT E DEZINFORMIMIT SI
BURIM JOSTABILITETI
- 18 GJETJET KYÇE
- 20 SHKRIMTARËT HESHTËN: BURIMET E CENSURËS
DHE TË VETËCENSURËS
- 21 SULME TË DREJTPËRDREJTA, PRESION
POLITIK DHE KËRCËNIME
- 23 GJUHA E URREJTJES DHE FUSHATAT SHPIFËSE
- 25 SULME VERBALE DHE KËRCËNIMET ONLINE:
SHKREPËS PËR DHUNË FIZIKE?
- 26 FAKTORËT SOCIO-EKONOMIKË BREJTËS TË TË
SHPREHURIT
- 27 EFEKTE RRËNQETHËSE: SHTYTJA DREJT
VETËCENSURËS
- 28 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

PARATHËNIE

Do të doja të theksoja qysh në fillim që ky raport është i përpiktë, i dokumentuar mirë, i interpretuar qartë në kontekstin historik, dhe që gjetjet e tij duhet të na brengosin thellësisht.

Gjatë leximit mbeta i tronditur nga fakti se sa shumë emra shkrimtarësh e intelektualësh të ekspozuar ndaj dhunës, kërcënimeve dhe mohimit të të drejtave të njeriut ishin të njohur për mua. Disa i kam pasur shokë të afërt nga koha e Jugosllavisë, kur bashkë luftonim për liri të shprehjes dhe për demokraci; disa të tjerë i njihja nga periudha tragjike e luftërave jugosllave, kur bashkëpunonim ngushtë për të shpëtuar jetë, për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe për të arritur perspektiva më të mira për të ardhmen.

Unë personalisht jam i lidhur ngushtë me të gjitha kulturat që kanë formuar ish-Jugosllavinë. I lindur nga prindër sllovenë në Beograd, ku edhe e kreu shkollën fillore, duke pasur kushërinj në Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci dhe Serbi, dhe duke udhëtuar nëpër Mal të Zi dhe Maqedoni, unë isha një fëmijë jugosllav. Babai im, Ante Novak, statistikist me profesion, hartoi raportin e parë demografik për Kosovën në fillim të viteve 1960, i cili qartazi tregoi se pa pasur standard më të lartë jetese, arsimimi dhe respekti për të drejtat e njeriut, Kosova do të shndërrohej në një ferr, gjë që përfundimisht edhe ndodhi në fazën e fundit të luftërave jugosllave, më 1999.

Në tetor të vitit 1991, derisa ne në Slloveni me lehtësim po shihnim tërheqjen e Ushtrisë “Popullore” Jugosllave, e agresioni ndaj Kroacisë veç sa kishte nisur tragjikisht, në cilësinë time si president i Qendrës Sllovene PEN fillova një fushatë humanitare për refugjatët që filluan të vinin në Slloveni nga pjesë të ndryshme të shtetit, dikur të përbashkët tonë, si pasojë e rreziqeve që sillnin lufta dhe përndjekja politike. Kjo ndihmë fillimisht u organizua në emër të PEN-it Slloven, dhe më vonë, kur u bë e qartë se ne nuk do të mund të përballonim një barrë kaq të rëndë financiare, në emër të PEN International. Nga nëntori i vitit 1992, ndihma jonë humanitare u përqendrua në Sarajevën e rrethuar, në qytetin ku filloi dhe mbaroi tragjedia botërore e shekullit të 20-të.

Do të riktheja kujtimin e vizitës tonë humanitare në qytetin e rrethuar në vitin 1994. Në grup ishim poeti boshnjak Josip Osti, dy kolegë sllovenë, poeti Niko Grafenauer, romancieri Drago Jančar dhe unë. E kishim statusin e delegacionit të UNESCO-s; autorizimin na e vërtetonte një letër e nënshkruar nga Frederico Mayor, drejtor i përgjithshëm i atëhershëm i UNESCO-s. Siç do ta kuptonim më vonë, ky dokument na kishte kursyer nga

shumë probleme, mbase na e kishte kursyer edhe jetën, kur u gjendëm të rrethuar nga 150-200 serbë të udhëhequr prej një grupi të rinjsh jo më të vjetër se 18 vjeç – fytyra ende me tipare fëmijërore – me kallashnikovë drejtuar nga ne. Unë i kisha me vete 20.000 marka gjermane dedikuar për shkrimtarët në Sarajevë; i kisha fshehur nën jelekun antiplumb, megjithëse kjo nënkuptonte ngjeshje e djersitje e një tube të madhe letrash, gjithë në kartëmonedha 5, 10 dhe 20 markash, meqenëse ato me vlerë më të madhe nuk kryenin punë në tregun e zi të Sarajevës.

Lufta në Bosnjë-Hercegovinë përfundoi në vitin 1995 me Marrëveshjen e Dejtonit, e cila ndali konfliktet e armatosura, por, për fat të keq, nuk arriti të zgjidhte shkaqet e tyre; sistemi politik i pasluftës në Bosnjë-Hercegovinë është në një ngërc të plotë. Tani, le t'i krahasojmë Jugosllavinë, Evropën dhe botën 28 vjet pas Luftës së Dytë Botërore, më 1973, dhe Ballkanin 28 vjet pas Marrëveshjes së Dejtonit, më 2023. Dallimi është tronditës. 1973 ishte një vit i prosperitetit të madh ekonomik për Jugosllavinë, por nën hijen e konflikteve etnike që nxitën rivendosjen e autokracisë komuniste të Titos. Evropa lulëzoi përsëri, pas shkundjes së fuqishme që mori nga demonstratat studentore të vitit 1968 në Paris dhe pushtimit sovjetik të Çekosllovakisë. Dhe ku është Ballkani 28 vjet pas luftërave tona të fundit tragjike, nga të cilat nuk kemi mësuar asgjë, asgjë fare? Sigurisht, kjo është pjesërisht pasojë e politikës së gabuar të komunitetit ndërkombëtar – por ka këtu edhe një pyetje të nxehtë për vetë Ballkanin: a nuk jemi edhe ne, banorët e Ballkanit, përgjegjës për mjerimin tonë ballkanik? A nuk është pafundësia e së keqes në Ballkan edhe faji ynë? A do të mbesim duke vajtuar dhe vajtuar dhe vajtuar si viktima të përhershme infantile të Historisë, duke kërkuar gjatë tërë kohës ndihmë nga të tjerët dhe në të njëjtën kohë duke i mallkuar për ndihmën e tyre – apo do TË BËJME diçka për këtë VETË?

Luftëtarët trima për lirinë e shprehjes dhe për demokracinë, të përmendur në këtë raport, janë shembuj të ndritshëm për të gjithë qytetarët dhe komunitetet në këtë rajon të trazuar. Ata janë heronjtë e vërtetë!

Ata meritojnë mirënjohjen tonë të ngrohtë. Hvala!

BORIS A. NOVAK

Poet slloven
Nënkryetar i PEN International

Shpërbërja e Jugosllavisë në vitet 1990 solli vdekje dhe shkatërrim në Ballkanin Perëndimor në një shkallë të paimagjinueshme. Komiteti i Shkrimtarëve për Paqe i PEN International shpreh shqetësim serioz lidhur me sfidat në rritje ndaj lirisë së shprehjes në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi, dhe kërcënimet që ato paraqesin për paqen dhe stabilitetin në rajon.

Ky raport jep hollësi mbi një mori sfidash me të cilat përballen shkrimtarët dhe gazetarët e pavarur në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi, përfshirë fushatat e dezinformimit dhe shpifjeve, gjuhën e urrejtjes, frikësimin dhe kërcënimet nga akterë brenda institucioneve shtetërore, por edhe jashtë tyre, paditë abuzive, si dhe stigmatizimin e vazhdueshëm dhe përpjekjet për të shtypur mendimet dhe raportimet kritike. Hapësira për zëra alternativë po tkurret, veçanërisht për ata që kundërshtojnë narrativat dominuese – shpesh nacionaliste – politike. Këto praktika janë veçanërisht të rrezikshme në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi – ku vazhdon të ketë tensione etnike – dhe kërcënojnë drejtpërdrejt paqen dhe stabilitetin.

Ky raport hedh dritë mbi dy pika kyç: a) nevojën urgjente për të mbrojtur lirinë e shprehjes dhe b) që të gjithë akterët – kombëtarë dhe ndërkombëtarë – të angazhohen për të garantuar lirinë e shprehjes për të gjithë ata që sfidojnë në mënyrë paqësore narrativat zyrtare.

Me këtë raport, ne synojmë të kërkojmë llogari nga qeveritë. Ato duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe për të ofruar mbrojtje ndaj kërcënimeve dhe akteve të dhunshme kundër shkrimtarëve dhe gazetarëve. Mohimi i gjenocidit e i krimeve të tjera brutale dhe glorifikimi i kriminelëve të luftës duhet të përfundojnë menjëherë. Liria e shprehjes është themeli i një shoqërie demokratike. Kur hapësira për të kufizohet, pasojnë abuzime të të drejtave të tjera të njeriut.

Duhet të mos harrojmë se pa liri të shprehjes nuk ka paqe të qëndrueshme.

GERMÁN ROJAS

Kryetar i Komitetit të Shkrimtarëve
për Paqe të PEN International

Luftëtarët trima
për lirinë e
shprehjes dhe
për demokracinë,
të përmendur
në këtë raport,
janë shembuj të
ndritshëm për të
gjithë qytetarët
dhe komunitetet
në këtë rajon të
trazuar. Ata janë
heronjtë e vërtetë!

Ata meritojnë
mirënjohjen tonë
të ngrohtë. Hvala!

BORIS A. NOVAK

Poet slloven
Nënkryetar i PEN International

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Ballkanin Perëndimor, rritja e gjuhës së urrejtjes, mohimi i gjenocidit e krimeve të tjera brutale dhe glorifikimi i kriminelëve të luftës nxjerrin në pah dështimin e vazhdueshëm të shteteve të këtij rajoni për t'i trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse shkeljet e rënda nga e kaluara. Shkrimtarët dhe gazetarët e pavarur, si dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, janë përballur me presione, frikësim dhe kërcënime në rritje nga akterë brenda institucioneve shtetërore, si dhe jashtë tyre, të cilët synojnë t'i heshtin mendimin dhe raportimin kritik të tyre, veçanërisht rreth shkeljeve të së kaluarës. Stigmatizimi i vazhdueshëm i zërave të pavarur nga liderët politikë dhe dështimi për të parandaluar dhe sanksionuar akte të tilla nxisin një klimë ankthi, frike dhe pasigurie. Kjo retorikë përçarëse është veçanërisht e rrezikshme në të gjithë Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën, Malin e Zi dhe Serbinë – ku vazhdon të kenë tensione etnike – dhe kërcënon drejtpërdrejt stabilitetin në rajon.

Ky raport përqendrohet te sfidat me të cilat ballafaqohen shkrimtarët dhe gazetarët në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi dhe te mënyrat se si pengohet pjesëmarrja e tyre në sferën publike si pasojë e përforcimit të lidhjes mes figurave politike dhe mediave, si dhe ndikimi i saj në të drejtat për liri të shprehjes, të mendimit dhe për qasje në informata. Raporti ka për qëllim t'i identifikojë sfidat kryesore me të cilat përballen shkrimtarët dhe gazetarët kur shprehin pikëpamjet dhe idetë e tyre dhe trajton dy pyetje kryesore:

- Si të ruhet liria e shprehjes në shoqëritë pas konfliktit dhe në transicion.
- Roli i akterëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë në ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për të siguruar më shumë platforma të hapura publike për individët aktivë – kryesisht shkrimtarët dhe gazetarët – si dhe për grupet dhe organizatat – përfshirë teatrot, shtëpitë botuese, grupet e vogla artistike dhe mediat alternative – që sfidojnë narrativat dominuese.

Raporti bazohet në hulumtim të të dhënave dhe në intervista me 20 shkrimtarë në Ballkanin Perëndimor. Ai më tej mbështetet në monitorimin e vazhdueshëm të lirisë së shprehjes në rajon nga PEN International, duke përfshirë edhe raportime lajmesh të konfirmuara dhe të dhëna të tjera publike.

Intervistat janë zhvilluar në periudhën mes shkurtit dhe marsit 2023, të realizuara qoftë me prezencë fizike qoftë përmes platformave online. Janë intervistuar gjithsej 20 shkrimtarë, analistë dhe botues, kontaktet e të cilëve janë siguruar me mbështetjen e Qendrave PEN në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi (35 ftesa janë dërguar dhe 20 persona janë përgjigjur pozitivisht).

PEN International falënderon individët dhe organizatat që pranuan të japin informata për këtë raport. Nëse nuk specifikohet ndryshe, emrat e të intervistuarve nuk janë shpalosur me kërkesë të tyre.

GJETJET KYÇE

Një model i qartë shfaqet kur hulumtohen kufizimet e pavend të së drejtës së lirisë së shprehjes në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi. Jo të gjithë shkrimtarët, gazetarët dhe individët e grupet e tjera të përfshira ballafaqohen me kufizime të tilla. Ato u vihen kryesisht atyre që vënë në dyshim narrativat zyrtare dhe kritikojnë autoritetet dhe njerëzit e pushtetit.

Krahasuar me gazetarët, shkrimtarët janë në një masë më të vogël të ekspozuar ndaj dhunës dhe kufizimeve të së drejtës për liri të shprehjes për shkak të shkrimeve të tyre letrare. Hulumtimi ynë ka vërtetuar se është kryesisht angazhimi i tyre publik që provokon reagimin e autoriteteve ose eksponentëve të tyre në formë tabloidesh dhe grupesh të djathta në internet.

Legjislacioni është në pjesën më të madhe i konceptuar mirë, por zbatimi është i dobët. Mungesa e transparencës së pronësisë së mediave është një shqetësim i rëndësishëm në këtë kontekst meqë platformave mediale që përhapin gjuhë të urrejtjes ose fushata dezinformuese në internet kundër shkrimtarëve, gazetarëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile shpesh u mungon impresumi që të mund të mbaheshin përgjegjës për përmbajtjen.

Fushatat dezinformuese kundër shkrimtarëve, gazetarëve dhe individëve të tjerë të angazhuar janë zakonisht hapi i parë në diskreditimin e tyre publik, të ndjekura nga fushatat e shpifjeve dhe të shënjestrimit në internet. Qëllimi kryesor është ekspozimi i individëve të angazhuar ndaj një furie zemërimi publik, kryesisht në mediat sociale, duke i etiketuar ata në përpjekje për t'i kthyer në armiq të shtetit dhe për të krijuar një "atmosferë linçimi" përpara çdo sulmi të mundshëm fizik kundër tyre. Është thelbësore të theksohet se rastet e kërcënimeve dhe të dhunës përdoren jo vetëm për t'u shkaktuar dëm individëve të tillë, por edhe për t'u dërguar porosi të gjithë zërave të pavarur se ata do ta përjetojnë të njëjtën gjë nëse guxojnë t'i kundërshtojnë narrativat dominuese - me fjalë të tjera, për të nxitur autocensurën.

Një tjetër fenomen i pranishëm në rajon është "blerja e heshtjes", ose ajo që shkrimtari i njohur Danilo Kish e ka quajtur "censurë miqësore". Në kontekstin aktual, kjo ndodh kur shkrimtarët dhe artistët marrin fonde publike për punën e tyre në këmbim të promovimit, ose të paktën të përmbajtjes nga kritika ndaj autoriteteve apo atyre në pushtet. Shkrimtarët e intervistuar kanë deklaruar se botuesit nuk u kërkojnë që të përmbahen nga përfshirja e ideve të caktuara në librat e tyre si kusht për botim. Por më shumë ka të bëjë me botuesit që u kërkojnë shkrimtarëve të mos jenë publikisht kritikë ndaj autoriteteve apo narrativave dominuese në mënyrë që të sigurojnë fondet për të botuar veprën e tyre letrare.

Përmbledhtazi, përveç kërcënimeve të drejtpërdrejta dhe sulmeve të mundshme, tashmë është bërë trend dominues dekurajimi nga të folurit i shkrimtarëve, gazetarëve, aktivistëve të shoqërisë civile dhe individëve të tjerë të angazhuar. Modeli është përpjekja për të blerë heshtje dhe për të nxitur autocensurë te shkrimtari dhe nëse kjo dështon, të nisë fushata dezinformuese dhe shpifëse në internet, në mënyrë që të bëhet objektiv i grupeve radikale dhe të ekspozohet ndaj kërcënimeve dhe dhunës. Si rezultat, hapësira për lirinë e shprehjes në rajon po tkurret, duke i prekur njësoj mediat, shkrimtarët dhe shoqërinë civile.

PEN International u bën thirrje autoriteteve të Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë që të mbështesin plotësisht të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të krijojnë një mjedis ku mund të zhvillohet debati i lirë publik. Hapat e parë drejt kësaj duhet të përfshijnë:

- Të dënohen publikisht, pa mëdyshje dhe sistematikisht të gjitha aktet e dhunës dhe sulmet që kanë në shënjestër shkrimtarët, gazetarët dhe aktivistët.
- Të sigurohen hetime të paanshme, të menjëhershme, të plota, të pavarura dhe efektive policore për të gjitha krimet e raportuara kundër shkrimtarëve dhe përgjegjësit të japin llogari. Të dedikohen resurset e nevojshme për hetimin dhe ndjekjen penale të sulmeve.
- Të krijohet një Regjistër zyrtar i mediave me të gjithë indikatorët e duhur medialë për të rritur transparencën e pronësisë së mediave dhe për të siguruar që personat e shënjestruar ta kenë në dispozicion informacionin e nevojshëm për veprime të mundshme ligjore.

Për rekomandime të hollësishme shihni kapitullin 4.

SFONDI

Liria e shprehjes në rajonin e Ballkanit Perëndimor është studiuar dhe hulumtuar deri më sot kryesisht në kontekstin e lirisë së mediave dhe presionit ndaj gazetarëve. Një pjesë më e vogël e të dhënave dhe analizave trajtojnë çështjen e hapësirës së hapur publike për angazhim përmes artit dhe aktivizmit. Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur shumë të dhëna për kufizimet e pavend të së drejtës së lirisë së shprehjes për shkrimtarët dhe krijuesit e tjerë të përfshirë në debate publike.

Ky projekt kërkimor rajonal fokusohet në sfidat me të cilat përballen shkrimtarët dhe gazetarët e angazhuar në shoqëri në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi dhe mënyrat në të cilat pjesëmarrja e tyre në sferën publike pengohet nga fuqitë politike, ekonomike dhe të tjera.¹ Rezultati është ky studim krahasues analitik që synon t'i përcaktojë çështjet kryesore me të cilat përballen këta shkrimtarë dhe gazetarë kur shprehin pikëpamjet dhe idetë e tyre.

Situata e lirisë së shprehjes në rajon është sfiduese dhe po përkeqësohet. Bosnjë-Hercegovina renditet e 64-ta, Kosova e 56-a, Serbia e 91-ta dhe Mali i Zi i 39-i në mesin e 180 vendeve në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit të Reporterëve pa Kufij 2023.² Shkrimtarët, gazetarët dhe individët, grupet dhe organizatat e tjera të angazhuara publikisht përballen me një “hapësirë në tkurrje” për zërat alternativë, që më së shpeshti karakterizohet me kufizim të mundësive dhe stimujve të angazhimit publik për ata që kundërshtojnë narrativat dominuese.³ Një çështje tjetër e pranishme në të gjithë rajonin është se derisa liria e fjalës po frenohet padrejtësisht, gjuha e urrejtjes po shënon rritje, kryesisht si mjet i akterëve politikisht të fuqishëm – sikur ata që janë në pushtet, ndonjëherë edhe ata në opozitë – për të vënë në cak të gjithë ata që guxojnë të mendojnë ndryshe dhe të shprehin mendimet e tyre hapur.

Pyetjet kryesore që duhen trajtuar në këtë kontekst janë:

- Si të ruhet liria e shprehjes në shoqëritë pas konfliktit dhe në transicion.
- Roli i akterëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë në marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të siguruar platforma publike më të hapura për individët aktivë – kryesisht shkrimtarët dhe gazetarët – si dhe grupet dhe organizatat – përfshirë teatrot, shtëpitë botuese, grupet e vogla artistike dhe mediat alternative – që sfidojnë narrativat dominuese.

METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në hulumtime të të dhënave nga zyra dhe në intervista me 20 shkrimtarë në rajon. Hulumtimi i të dhënave ekzistuese ka synuar kryesisht mbledhjen e informacionit rreth situatës për lirinë e shprehjes në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi, ndërsa intervistat janë shfrytëzuar për të mësuar nga përvojat e drejtpërdrejta të shkrimtarëve në rajon dhe nga perceptimi i tyre për pengesat kryesore të lirisë së shprehjes.

Intervistat janë zhvilluar në periudhën mes shkurtit dhe marsit 2023, të realizuara qoftë me prezencë fizike qoftë përmes platformave online. Janë intervistuar gjithsej 20 shkrimtarë, analistë dhe botues, kontaktet e të cilëve janë siguruar me mbështetjen e Qendrave PEN në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi (35 ftesa janë dërguar dhe 20 persona janë përgjigjur pozitivisht). Të gjithë të intervistuarit kanë nënshkruar një deklaratë pëlqimi, duke deklaruar nëse pranonin apo jo të citoheshin në raport me kredencialet e tyre të plota. Nëse nuk specifikohet ndryshe, emrat e të intervistuarve nuk janë shpalosur me kërkesë të tyre.

Të gjithë të intervistuarve dhe bashkëbiseduesve kryesorë iu janë bërë të njëjtat pyetje, për të mundësuar një analizë krahasuese. Këto pyetje kanë pasur të bëjnë me:

- Kërcënimet dhe presionin e drejtpërdrejt (politik, ekonomik dhe të tjera) drejtuar shkrimtarëve dhe individëve e tjerë të angazhuar, porositë e të cilëve kundërshtojnë narrativat dominuese.
- Fushatat shpifëse përmes mediave tabloide dhe rrjeteve sociale.⁴
- Censurën dhe autocensurën.⁵
- Zgjidhjet e mundshme për të adresuar kufizimet e pavend të së drejtës së lirisë së shprehjes në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe rolin e mundshëm të akterëve ndërkombëtarë, duke përfshirë PEN International.

Analiza e hulumtimit të të dhënave përshkruan kornizën ligjore dhe nivelin e zbatimit të saj, dhe jep hollësi mbi dy aspekte të rëndësishme të kufizimeve të pavend ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes, të cilat kanë të bëjnë me:

- Deformimin e së kaluarës dhe ndërtimin e narrativave dominuese populiste rreth ngjarjeve të viteve 1990, të cilat, kur sfidohen, bëhen bazë për shpifje dhe diskreditim të shkrimtarëve, gazetarëve dhe individëve të tjerë të angazhuar.
- Dezinformimin si mjet për destabilizim të rajonit; mobilizimin etno-kombëtar dhe frikën si mjete për ta ruajtur *status quo*-në në shoqëri.

Kjo analizë krahasuese përshkruan synon të identifikojë modele identike ose të ngjashme të sjelljes nga autoritetet ndaj shkrimtarëve dhe gazetarëve të pavarur dhe t'i shqyrtojë mjetet e mundshme për t'i trajtuar ato.

Pjesa empirike e raportit, e bazuar në intervista, shfrytëzon bashkëbiseduesit kryesorë si dëshmitarë të ngjarjeve dhe trendëve në mjedisin ku ata punojnë, dhe mbështetet në përvojat dhe vëzhgimet e tyre. Kjo pjesë e raportit përdor një metodë analize me dy shtresa:

- Rastet studimore: përvojat personale të të intervistuarve me kërcënime, fushata shpifjesh, censurë dhe autocensurë.
- Përgjithësimi: mendimet dhe përshtypjet e të intervistuarve mbi trendët e përgjithshme rreth kufizimeve të pavend të së drejtës për liri të shprehjes.

Si te hulumtimi i të dhënave nga zyra ashtu edhe te komponentët empirikë të raportit, është përdorur metodë krahasuese për analizimin e të dhënave, për të identifikuar trendët dhe ngjashmëritë në qasjen e autoriteteve në rajon ndaj shkrimtarëve, gazetarëve dhe individëve të tjerë të angazhuar publikisht dhe të drejtës së tyre për liri të shprehjes.

1 Në shumë raste shkrimtarët janë edhe kolumnistë, ndaj edhe pse nuk janë gazetarë në kuptimin tradicional të fjalës, ata janë pjesë e skenës mediatike dhe sferës publike si individë të angazhuar.

2 Reporterët pa Kufij, 2023 Word Index Freedom Press, Evropa dhe Azia Qendrore, e gjeni në: <https://rsf.org/en/classement/2023/europe-central-asia>

3 On Shrinking Space: A Framing Paper, 2017, e gjeni në: https://www.tni.org/files/publication-downloads/on_shrinking_space_2.pdf

4 Për më shumë informacion, shih Samolienko SA, Icks M., Keohane J., Shiraev E. Routledge Handbook of Character Assassination and Reputation Management, 2021 dhe Torrenzano R., Davis MW Digital Assassination: Protecting Your Reputation, Brand or Business Against On Attacks Online, 2011.

5 Dita J. Çfarë është autocensura dhe si e vret lirinë e medias? 2021, e gjeni në: <https://www.liberties.eu/en/stories/self-censorship/43569>

LIRIA E SHPREHJES NË RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR: VËSHTRIM



Protestuesit dhe aktivistët në Banjallukë kundërshtojnë projekt-amendamentet në Kodin Penal të Republikës Serbe që parashohin dënime të larta për shpifje (korrik 2023). Foto: Radio Evropa e Lirë/Radio Liberty.

BOSNJË-HERCEGOVINA

E drejta e lirisë së shprehjes në Bosnje dhe Hercegovinë është e garantuar me nenin II të Kushtetutës.⁶ Megjithatë, që kur Marrëveshja e Përgjithshme Kornizë për Paqe në Bosnjë-Hercegovinë (Marrëveshja e Dejtonit) u nënshkrua në vitin 1995, shumica e studimeve dhe të dhënave kanë treguar për kufizime të pavend të së drejtës së lirisë së shprehjes. Kjo veçanërisht ndodhë kur bëhet fjalë për lirinë e mediave, lirinë digjitale si dhe për lirinë akademike. Sipas një Raporti të vitit 2022 nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) mbi sigurinë

e gazetarëve dhe qasjen në informata në Bosnjë-Hercegovinë, “shkeljet e së drejtës për liri të shprehjes dhe kërcënimet ose përdorimi i dhunës, ngacmimet dhe frikësimet që kanë për cak gazetarët kërkojnë një përgjigje gjithëpërfshirëse për t’i adresuar çështjet strukturore dhe ato në zhvillim që ndikojnë në pavarësinë e mediave dhe në sigurinë e gazetarëve”.⁷ Në vitin 2022, Shoqata e Gazetarëve “BH Novinari” raportoi gjithsej 79 raste të sulmeve kundër gazetarëve, duke përfshirë një sulm fizik dhe shtatë kërcënime me vdekje.⁸ Millorad Dodik, president i Republikës Serbe – një nga dy entitetet federale të Bosnjë-Hercegovinës – ngacmon dhe shan në mënyrë të vazhdueshme gazetarët e spikatur në forume publike, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi frike dhe mosndëshkimi për sulmet verbale dhe fizike. Në mars të vitit 2023, pak pasi Dodiku kritikoi gazetarët që

⁶ Kushtetuta e Bosnjë-Hercegovinës, e gjeni këtu: https://www.ustavnisud.ba/public/down/USTAV_BOSNE_I_HERCEGOVINE_bos.pdf

⁷ OHCHR, siguria e gazetarëve dhe qasja në informacion në Bosnjë-Hercegovinë, 2022, e gjeni këtu: <https://bosniaherzegovina.un.org/sites/default/files/2022-09/Report%20-%20Safety%20of%20journalists%20dhe%20qasje%20në%20informacion%20në%20Bosnjë%20dhe%20Hercegovinë%20-%20ENG.pdf>

⁸ Sarajevo Times, Sulmet fizike dhe kërcënimet me vdekje kundër gazetarëve në BH, 12 janar 2023, e gjeni këtu: <https://sarajevotimes.com/physical-attacks-and-death-threats-against-journalists-in-bih/>

kishin kundërshtuar propozimin e tij për ri-kriminalizimin e shpifjes, duke i quajtur ata përbindështa (spodobe)⁹, veturat e dy gazetarëve në Banjallukë u dëmtuan nga persona të panjohur.¹⁰ Disa aktivistë dhe gazetarë u sulmuan verbalisht dhe fizikisht në Banjallukë po atë muaj pasi Policia e Republikës Serbe ndaloi një ngjarje të paradës së Krenarisë për shkak të shqetësimeve rreth sigurisë.¹¹ Deri në momentin e shkrimit, nuk është bërë asnjë arrestim.

Më 20 korrik 2023, Asambleja Kombëtare e Republikës Serbe miratoi ndryshime në Kodin Penal të Republikës Serbe duke rifutur dënimet penale për shpifje, pavarësisht kundërshtimeve vendore dhe ndërkombëtare.¹² Derisa propozim-amendamenti që synonte kriminalizimin e fyerjes përfundimisht u tërhoq, dispozitat e formuluar në mënyrë të paqartë do t'i ndëshkojnë shpifjen dhe shkeljet e tjera lidhur me privatësinë me gjoba të ashpra deri në 6000 BAM (afërsisht 3000 €), që është trefishi i pagës mesatare mujore. Ligji lejon interpretimin subjektiv dhe mundëson vendimmarrje arbitrare për të nisur ndjekje penale të motivuara politikisht kundër shkrimtarëve dhe gazetarëve. Amendamentet e propozuara përbëjnë një kërcënim serioz jo vetëm për ata në Republikën Serbe, por për të gjithë shkrimtarët, gazetarët dhe qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës, pavarësisht nga kufijtë. Ata që nuk janë në gjendje të paguajnë gjobën mund të dënohen me burgim. Kushdo që shpallet fajtor do të ketë një precedent penal, gjë që mund ta bëjë më të vështirë ushtrimin e një sërë të drejtash dhe lirish themelore, përfshirë të drejtën për punë.¹³ PEN International kundërshtoi shpifjen si vepër penale në të gjitha rastet. Kriminalizimi i shpifjes, qoftë i personave publikë apo individëve privatë, është përgjigje joproporcionale dhe e panevojshme ndaj nevojës për ta mbrojtur reputacionin. Çështjet e reputacionit duhet të trajtohen si çështje të së drejtës civile dhe duhet të përcaktohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Fushatat e ngacmimit, frikësimit dhe të shpifjeve zhvillohen shpesh në internet dhe në platformat e mediave sociale dhe synojnë të mbyllin gojën jo vetëm të gazetarëve, por edhe të individëve të tjerë të shquar që janë aktivë

Milorad Dodik, president i Republikës Serbe, ngacmon dhe shan në mënyrë të vazhdueshme gazetarët e spikatur në forume publike, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi frike dhe mosndëshkimi për sulmet verbale dhe fizike.

në sferën publike në Bosnjë-Hercegovinë. Fushatat e shpifjeve në internet kryhen nga trolle anonime dhe shpesh mbështeten nga zyrtarë publikë, të cilët zyrtarisht mohojnë çdo përgjegjësi apo lidhje me personat dhe grupet që sulmojnë gazetarët dhe individët e shquar në internet. Gjuha e urrejtjes, siç raportohet, është në rritje dhe veçanërisht në platformat e mediave sociale.¹⁴

Shkrimtarët Dragan Markovina dhe Marko Tomash, si dhe një nga redaktorët në ueb portalin Prometej.ba, janë në mesin e atyre që janë ekspozuar ndaj fushatave të tilla shpifëse nga ish-gazetari Adisa Busulaxhiq. Monitorimi i llogarive të saj në mediat sociale ka demonstruar një përpjekje të vazhdueshme për të fyer, shpifur dhe përhapur narrativa urrejtjeje.¹⁵ Aktet e solidaritetit me shkrimtarët dhe gazetarët që janë ballafaquar me situata të ngjashme janë megjithatë inkurajuese. Në vitin 2018, për shembull, një grup intelektualësh lëshuan një letër të hapur në mbështetje të profesorit Enver Kazaz, i cili ishte sulmuar verbalisht dhe fizikisht nga redaktori i një reviste të djathtë në sallën e fakultetit të tij, i cili gjithashtu e kërcënoi atë duke thënë se “do t'i pritej fyti”.



Të paktën 50 protestues dhe më shumë se 10 paqeruajtës të NATO-s u plagosën në Zvečan, në veri të Kosovës më 29 maj 2023. Përplasjet shpërthyen pasi kryetarët shqiptarë morën detyrën në komunat me shumicë serbe në pjesën veriore të Kosovës, pas zgjedhjeve lokale të cilat u bojkotuan nga serbët. Foto: Shkodrane Dakaj.

KOSOVË

Sipas raportit vjetor të “Freedom House” për vitin 2023, “liria e mediave po sfidohet gjithnjë e më shumë në Kosovë pasi mediat vazhdojnë të largohen nga mbulimi kritik i punës së qeverisë, dhe zyrtarët u përgjigjen gazetarëve me më shumë masa rregulluese ose fushata shpifëse.”¹⁶ Neni 40 i Kushtetutës së Kosovës, e miratuar në vitin 2008, garanton lirinë e shprehjes.¹⁷ Vitet e fundit është bërë përparim domethënës në forcimin e kornizës ligjore. Një ligj i vitit 2013 për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve është vlerësuar nga ekspertët dhe profesionistët e mediave, ndërsa ligji i vitit 2018 për mbrojtjen e sinjalizuesve vendos rregulla për sinjalizimin dhe përcaktimin e të drejtave të informatorëve të fshehtë në media. Shpifja është dekriminalizuar, megjithëse paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) kundër mediave dhe gazetarëve mbeten një shqetësim.¹⁸

Sipas Bordit Ndërkombëtar për Kërkime dhe Shkëmbime (IREX), “Kosova ka liri të fjalës, por diskutimi publik për çështje më të ndjeshme mbetet problematik”.¹⁹

Komisioni Evropian në vitin 2022 arriti në përfundimin se “për sa i përket lirisë së shprehjes, Kosova ka një nivel të përgatitjes dhe përfiton nga një mjedis pluralist dhe i gjallë mediatik. Megjithatë, shqetësimet mbeten në lidhje me fushatat e shpifjeve publike, kërcënimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve. Mungesa e vetëqëndrueshmërisë financiare i lë mediat, përfshirë transmetuesin publik, të cenueshme ndaj interesave politike dhe të biznesit”.²⁰

Pozicioni i shkrimtarëve, në kuptimin ekzistencial, është sfidues. Shkrimtari Shpëtim Selmani e shpjegon kështu: **“Në Kosovë tregu i librit është jashtëzakonisht i vogël. Të mos flasim për çështjen nëse lexohen apo jo librat, sepse kam përshtypjen se leximi tani është në krizë kudo. Por vendet e vogla vuajnë gjithmonë më shumë nga kriza. (...) Si autor, ti e kupton se letërsia është gjithashtu një lloj industrie. Në këtë industri, libri juaj pastaj është një nga produktet që futet në treg. Është shumë e vështirë të jetosh nga letërsia. Në Kosovë kjo është thujse e paimagjinueshme”.**²¹

Fushatat e shpifjeve dhe retorika e ashpër kundër mediave dhe gazetarëve nga disa politikanë dhe zyrtarë publikë

9 Srpskainfo , 8 mars 2023, në dispozicion në: <https://srpskainfo.com/onaj-vukelic-i-neke-druge-spodobe-dodik-ovako-naziva-novinare-i-istovremeno-uredjuje-oblast-klevete-u-srpskoj--video-foto/>

10 Mediacentar , 9 mars 2023, e gjeni në: <https://media.ba/ba/vijesti-i-dogadaji-vijesti/osteceni-automobili-novinara-morace-i-trifunovica>

11 AP News, Bosnje: sulmohen aktivistët e të drejtave të njeriut pas ndalimit të ngjarjeve LGBT, 19 mars 2023, e gjeni në: <https://apnews.com/article/bosnia-serb-lgbt-assault-2bd5a4836f047fe88ff039ee2f190af7>

12 PEN International, Bosnjë-Hercegovinë (Republika Serbe): Hiqni dorë nga projektligji për shpifjen penale, 22 maj 2023: <https://www.pen-international.org/news/bosnia-and-herzegovina-republika-srpska-drop-criminal-defamation-fature>; Radio Evropa e Lirë/Radio Liberty, Ligji për shpifjen miratuar nga Asambleja Kombëtare e Republikës Serbe të Bosnjës megjithë kritikën nga aktivistët e të drejtave, 21 korrik 2023, e gjeni këtu: <https://www.rferl.org/a/bosnia-srpska-defamation-law-kriminalizim-kritikë/32512853.html>

13 Osservatorio Balcani e Kaukazi Transeuropa , BiH: Republika Serbe rifut krimin e shpifjes, 24 korrik 2023, e gjeni në: <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Bosnia-Hercegovina/BiH-Republika-Srpska-reintroduces-the-crime-of-shpifje-226384>

14 Një nga rastet më të spikatura të trollimit në internet është ai i Jasmin Mulahusiq , të cilin Prokuroria e Bosnjë-Hercegovinës po e heton me dyshimin se ka kryer veprën penale të nxitjes së urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare, përçarje dhe intolerancë. Mulahusiq fyen në mënyrë rutinore gazetarët nga Bosnjë-Hercegovina në llogarinë e tij në Facebook. Objektivat e postimeve të tij janë gazetarë nga Al Jazeera Balkans, Televizioni N1, Face TV, RFE/RL dhe gazetarë të pavarur, të cilët ose flasin në mënyrë kritike për Partinë e Veprimit Demokratik (SDA) ose raportojnë për partitë politike opozitare. Për më shumë informacion, shihni Gazetarët e Sigurt, Gazetarët e BH: Jasmin Mulahusiq duhet të sanksionohet për përhapjen e urrejtjes ndaj gazetarëve!, 18 tetor 2022, e gjeni në: <https://safejournalists.net/bh-journalists-jasmin-mulahusiq-must-be-sanksionuar-per-perhapje-urrejtje-ndaj-gazetarëve/>. Autorët e këtij raporti janë ngacmuar edhe në internet nga Mulahusiq në 2021 dhe 2023.

15 Prometej, 31 janar 2023, e gjeni në: <http://www.prometej.ba/clanak/osvrti/franjo-sarcevic/lice-mrznje-5551>

16 Freedom House, Kombet në Transicion 2023, Kosovë, e gjeni në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/nations-transit/2023>

17 Kushtetuta e Kosovës e vitit 2008 me amendamente deri në vitin 2016, e gjeni në: https://www.constituteproject.org/constitution/Kosovo_2016.pdf?lang=en

18 Mediat Ballkanike, Liria e Mediave në Kosovë, e gjeni në: <https://www.kas.de/en/web/balkanmedia/media-freedom4>

19 IREX, Vibrant Barometer Information 2021, e gjeni në: <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/vibe-kosovo-2021.pdf>

20 Komisioni Evropian, Gjetjet kryesore të Raportit 2022 për Kosovën, e gjeni në: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/country_22_6090

21 Kosovo 2.0, Shpëtim Selmani: Gjithë jetën kam qenë në kërkim të një bote tjetër, e gjeni në: <https://kosovotwopointzero.com/en/shpetim-selmani-all-my-life-i-have-been-in-search-of-a-botes-tjetere/>

i kontribuojnë, po ashtu, pasigurisë si përpjekje për ta kufizuar lirinë e mediave.²² Blerim Vela, shefi i kabinetit të Zyrës së Presidentes Osmani, kritikoi mediat në Twitter **në mars të vitit 2023**, pasi raportuan për një vendim në pritje të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës që mund të anulonte zgjedhjen e presidentes Osmani. Në një seri postimesh në Twitter, Vela shkroi se raportimet e mediave kosovare janë “pjesë e një lufte speciale të zhvilluar sipas skenarit të Beogradit dhe që zhvillohet përmes kriminelëve nga veriu i Kosovës dhe ndërmjetësve të tyre, të cilët janë në listën e zezë të SHBA-së”.²³ Akterët ndërkombëtarë, përfshirë “Safejournalists Network”, më pas kërkuan nga autoritetet që ta ndalin frikësimin e gazetarëve në Kosovë.²⁴

Tensionet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës kanë rezultuar në pasiguri në rritje për gazetarët dhe individët e tjerë aktivë, veçanërisht ata që raportojnë për zhvillimet politike. Gjashtë sulme ndaj gazetarëve janë regjistruar në veri të Kosovës në dhjetor 2022; gazetarja Leonita Bajrami u vu në shënjestër të eksplozivëve piroteknikë.²⁵ Në maj të vitit 2023, një valë sulmesh ndaj gazetarëve dhe mediave shpërtheu pasi kryetarët shqiptarë që morën detyrën në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës nxitën trazira dhe protesta të dhunshme. U raportua për dhjetëra gazetarë që qëllimisht u bënë cak i sulmeve duke përfshirë ato fizike, si dhe vandalizmin e pajisjeve profesionale. Grupet e lirisë së shtypit u bënë thirrje autoriteteve t’i marrin masat e nevojshme për ta garantuar sigurinë e gazetarëve.²⁶

Tensionet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës kanë rezultuar në pasiguri në rritje për gazetarët dhe individët e tjerë aktivë, veçanërisht ata që raportojnë për zhvillimet politike.

MALI I ZI

Sipas Reporterëve pa Kufij, “Kushtetuta dhe ligjet e Malit të Zi garantojnë lirinë e fjalës dhe të shprehjes, por liria e shtypit vazhdon të kërcënohet nga ndërhyrjet politike, sulmet e pandëshkuara ndaj gazetarëve dhe presionet ekonomike”.²⁷ Në përgjithësi, situata në lidhje me lirinë e mediave është problematike dhe “Mali i Zi është një nga mjediset më armiqësore për raportim hulumtues në mesin e vendeve të Evropës Juglindore.”²⁸

Gjuha e urrejtjes, veçanërisht në internet, përdoret për të kërcënuar, trembur dhe heshtur gazetarët dhe aktivistët e pavarur në Mal të Zi. Që nga viti 2020, autoritetet publike kanë bërë përpjekje të shumta për ta frenuar lirinë e shprehjes. Sipas Qendrës për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (CEDEM), gjuha e urrejtjes është shtuar viteve të fundit. “Gjatë vitit 2020, liria e shprehjes u kërcënua nga autoritetet në lidhje me krizën e COVID-19 dhe me fushatat zgjedhore. Përkatësisht, u ndërmorën disa hapa që cenuan rëndë të drejtat për privatësi dhe për liri të shprehjes. Në valën e parë të COVID-19, qeveria ndërmori hapa shtypës për t’i ndëshkuar “dezinformatat” rreth virusit, duke miratuar masa për të luftuar një pandemi që ata e konsideruan “lajm të rremë”. Për shkak të fuqisë në rritje të partive politike të krahut të djathtë, tensionet etnike po rriten, veçanërisht midis të rinjve, ndërsa gjuha e urrejtjes ka arritur nivelet më të larta në shoqërinë malazeze. Në anën tjetër, ende mungon reagimi adekuat nga institucionet kompetente si përgjigje ndaj incidenteve të raportuara të gjuhës së urrejtjes dhe lajmeve të rreme në media apo në rrjetet sociale”.²⁹

Zyrtarët publikë në Mal të Zi, gjithashtu, kanë njoësuar dhe sulmuar verbalisht individë, shkrimtarë dhe gazetarë të shquar. Më 19 gusht 2022, kryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazović, sulmoi publikisht në Parlament qendrën malazeze PEN, duke e akuzuar për përhapje të “ekstremizmit dhe nacionalizmit”. Abazović tregoi veçanërisht një fotografi të shkrimtarit malazet fitues të çmimeve dhe anëtarit të Qendrës Malazeze PEN, Milorad Popović, duke e etiketuar atë si agjent i politikës nacionaliste që “u shërben interesave të



Shkrimtari malazet, fitues i çmimeve dhe anëtar i Qendrës Malazeze PEN, Milorad Popović, u etiketua si agjent i politikës nacionaliste që “u shërben interesave të kimit” nga kryeministri i Malit të Zi, Dritan Abazović, në gusht 2022.

krimit”. Kjo nuk ishte hera e parë që Abazović ka vënë në shënjestër publikisht anëtarët e Qendrës Malazeze PEN, duke njoësuar vazhdimisht shkrimtarin e shquar malazet dhe anëtarin e Qendrës PEN malazeze, Andrej Nikolaidis.³⁰ Popović dhe Nikolaidis janë kundërshtarë të zëshëm të përpjekjeve ruse dhe serbe për të ndërhyrë në punët e brendshme malazeze.

Në vitin 2022 u regjistruan 19 sulme ndaj gazetarëve dhe shtëpive mediatiqe. Prej tyre, tetë ishin sulme fizike ndaj gazetarëve, shtatë kërcënime ndaj gazetarëve përmes internetit, tri sulme fizike në shtëpi mediatiqe dhe një kërcënim në adresë të një shtëpie mediatiqe.³¹ Ende nuk është drejtësi e plotë për vrasjen e gazetarit, Dushko Jovanović, në vitin 2004.

Të gjitha këto arsye u renditën nga shkrimtarët në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi si metoda për të heshtur zërat e atyre që guxojnë të flasin kundër narrativave dominuese. Shkrimtarët shpesh janë të ekspozuar ndaj censurës nga pronarët e mediave ose redaktorët që refuzojnë të botojnë artikuj që mund të krijojnë probleme dhe të provokojnë zemërim publik.

SULME TË DREJTPËRDREJTA, PRESION POLITIK DHE KËRCËNIME

Kërcënime verbale dhe sulmet fizike ndaj shkrimtarëve, gazetarëve, kolumnistëve dhe intelektualëve të angazhuar janë të shpeshta në rajon. Edhe pse liria e shprehjes garantohet me Kushtetutë në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi, pjesa më e madhe e mediave i nënshtrohet formave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të kontrollit të brendshëm politik, duke ndikuar në përmbajtje që publikohet dhe duke rezultuar në mbështetje të hapur për parti të caktuara politike, pasqyrim selektiv të ngjarjeve politike dhe trajtim të pabarabartë të akterëve në sferën politike.

Shkrimtarët veprojnë në një atmosferë gjithnjë e më toksike dhe ngufatëse, me pasoja të rënda për lirinë e shprehjes. Gazetarët që konsiderohen të afërt me parti të caktuara politike janë shndërruar në zëdhënës të tyre. Ata që nuk duan askënd t'u kufizojë shkrimet përballen me probleme të shumta – ekzistenciale, punojnë nën presion dhe janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe ofendimeve të ndryshme verbale.

Të intervistuarit kanë ndarë përvojat personale dhe ato të kolegëve të tyre. Ata kanë shpjeguar se numrin më të madh të kërcënimeve e kanë marrë në platformat e mediave sociale. Ato kanë qenë kryesisht mesazhe anonime, ku u thuhej se si do të plagoseshin ose vriteshin, ose më së shpeshti duke i fyer me nofka nënçmuese si tradhtarë, shërbëtorë të ambasadave të huaja, jopatriotë ose shkatërrues të shtetit.

Të intervistuarit kanë vënë theksin te ajo se si liderët politikë dhe zyrtarët publikë shpesh kanë kontaktuar redaktorët e mediave për përmbajtjen që ata kanë publikuar – ndonjëherë përmes ndërmjetësve, ndonjëherë duke telefonuar personalisht – meqë synimi i tyre ka qenë që të ndërhyjnë drejtpërdrejt në politikën editoriale dhe të inkurajojnë censurën. Gjuha e urrejtjes dhe fushatat e shpifjeve kundër shkrimtarëve dhe gazetarëve zakonisht fillojnë në platformat e mediave sociale. Në fushata të tilla raportohet se janë të përfshirë liderët politikë dhe zyrtarët publikë, këshilltarët

e tyre dhe figura të ndryshme publike të afërta me parti të caktuara politike. Ngacmimet dhe kërcënimet në internet janë të shpeshta dhe zakonisht nuk hetohen, duke i lënë shkrimtarët të ndihen thellësisht të pasigurt.

Disa të intervistuar kanë theksuar se kërcënime ndaj shkrimtarëve më së shumti rrjedhin nga paraqitjet dhe rubrikat e tyre publike dhe jo nga shkrimet e tyre letrare.

Bojan Krivokapiq, një shkrimtar nga Serbia tha: *“Mendoj se letërsia, veçanërisht vitet e fundit, është aq e marginalizuar sa nuk paraqet rrezik potencial për ideologjinë dominuese. E kam fjalën për atë lloj letërsie që nuk i përket fushës së ideologjisë dominuese”*.

Lejla Kalamujiq, shkrimtare fituese e çmimeve nga Bosnjë-Hercegovina, ndau një mendim të ngjashëm, duke thënë se ajo besonte se njerëzit i ndiqnin më shumë angazhimin dhe paraqitjet publike të shkrimtarëve sesa që i lexonin librat e tyre. *“Unë besoj se shkrimtarët janë të ekspozuar ndaj presionit më shumë për shkak të angazhimit të tyre shoqëror sesa veprave të tyre letrare. Mendoj se shkrimtarët janë më nën presion nëse botojnë diçka në formën e një rubrike apo interviste, dhe jo për shkak të përmbajtjes së njëjtë të botuar në një roman, poezi, dramë. Megjithatë, ka përjashtime. Së fundmi ka ndodhur që regjisorja Selma Spahiq dhe Teatri Kombëtar nga Sarajeva janë ‘sulmuar’ për shkak të përmbajtjes së shfaqjes teatrore ‘Idiot’ – për shkak të përshtatjes së tekstit”*.⁶⁸

Profesori, aktivisti dhe shkrimtari Igor Shtiks, me seli në Beograd, Serbi, në kohën e shkrimit, tha: *“Librat nuk kanë ndikimin që kanë pasur dikur. Audienca nuk është më një audiencë letrare, por më parë një audiencë e përgjithshme dhe e orientuar drejt mediave. Në këtë kontekst, angazhimi publik i shkrimtarëve është më problematik sesa shkrimet dhe librat e tyre”*.

Intervistat me shkrimtarë të angazhuar, profesorë, intelektualë dhe kolumnistë kanë identifikuar llojet më të zakonshme të sulmeve të drejtpërdrejta të përdorura për t'i heshtur ata, si më poshtë:

- Diskreditimi publik i shkrimtarëve, duke selektuar dhe përdorur jashtë kontekstit fjali që ata kanë shkruar.
- Postimi i hollësive nga jeta e tyre private në internet dhe në tabloidet pro-qeveritare.

- Duke i quajtur me emra nënçmues.
- Padi abuzive nga politikanë apo zyrtarë publikë, të cilët i akuzojnë se ua kanë dëmtuar reputacionin me artikujt, kolumnet e tyre, etj.
- Kërcënime anonime përmes porosive të drejtpërdrejta në platformat e mediave sociale.

Në përgjithësi, në të gjithë rajonin, mbizotëron mosbesimi ndaj policisë dhe sistemit të drejtësisë, gjë që i dekurajon shkrimtarët dhe gazetarët nga raportimi i sulmeve dhe kërcënimeve. Procesi gjyqësor për lëndët penale dhe civile mbetet i ngadaltë. Grumbullimi i rasteve të pazgjdhura ka pasur po ashtu efekt frenues në raportimin e krimeve. Në rastet kur lëndët edhe arrijnë në gjykata, procedurat janë sistematikisht të stërzgjatura ndërsa akuzat kundër kryerësve minimale.⁶⁹ Mosndëshkimi vazhdon, duke inkurajuar kërcënime dhe sulmet e mëtejshme. Selvedin Avdiq është redaktor dhe gazetar i revistës “Žurnal” në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë. Ai është edhe shkrimtar, librat e të cilit janë përkthyer në disa gjuhë dhe janë kthyer në drama. *“Unë punoj në revistën online ‘Žurnal’ dhe ekipi ynë është nën presion të vazhdueshëm. Ka pasur gjithçka - nga kërcënime, sulmet fizike, tentativat për diskreditim, dhe aktualisht më të shpeshtat janë paditë. Për shkak të pretendimeve për një tekst, ne pranojmë disa padi. Për këto padi vendoset në gjykata të ndryshme. Disa prej tyre kanë pretendime krejtësisht joreale për dëmshpërbim dhe disa janë komike në shpjegimet e tyre për ankthin mendor që kemi shkaktuar. Ekspertët e mediave që i kemi konsultuar i kanë karakterizuar një sërë prej këtyre padive si shembuj klasikë të SLAPP-ve. Numri më i madh i padive vjen nga politikanë apo manjatë të afërt me ta. Paditë nga qytetarët e ‘zakonshëm’ janë shumë të rralla”*.

Shkrimtarja, poetja dhe kolumnistja Ferida Duraković thekson se ndasitë kombëtare janë tejet dominuese në shoqërinë boshnjake dhe kanë ndikuar edhe në vetë Qendrën PEN të Bosnjë-Hercegovinës. Duraković është një nga themelueset e Qendrës, e hapur gjatë luftës në vitin 1992. *“Pas përfundimit të luftës në Bosnjë-Hercegovinë, filluan presionet politike në Qendrën PEN. Na u kërkua që të bëheshim PEN Qendër boshnjake. Kjo u kundërshtua nga PEN International (më duket se ishte në vitin 1999) duke deklaruar se do të pranonin vetëm një Qendër shumëkombëshe në Bosnjë-Hercegovinë. Kishte gjithashtu presion*

⁶⁷ Deklaratat dhe veprimet e ambasadave britanike dhe amerikane në rajon gjenerojnë komente negative nga mbështetësit e politikave nacionaliste, të cilët besojnë se këto ambasada përfaqësojnë të ashtuquajturat vlera properëndimore dhe shkatërrojnë ‘traditën’. Ata dënojnë në mënyrë specifike mbështetjen e ambasadave britanike dhe amerikane për të drejtat LGBTI dhe gazetarët e persekutuar, të konsideruar si tradhtarë.

⁶⁸ Selma Spahiq është regjisorë teatri që drejtoi shfaqjen *Idiot*, një adaptim i romanit të Dostojevskit, e cili u shfaq premierë në shkurt të vitit 2023. Përmes shfaqjes, Spahiq kritikoi qeverinë aktuale ruse dhe luftën e Federatës Ruse kundër Ukrainës. Ambasada ruse në Bosnjë-Hercegovinë lëshoi një deklaratë duke kritikuar shfaqjen si të dobët dhe antiruse.

⁶⁹ OHCHR, siguria e gazetarëve dhe qasja në informacion në Bosnjë-Hercegovinë, 2022, e gjeni në: <https://bosniaherzegovina.un.org/sites/default/files/2022-09/Report%20-%20Safety%20of%20journalists%20dhe%20qasje%20në%20informacion%20në%20Bosnjë%20dhe%20Hercegovinë%20-%20ENG.pdf>; Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Serbi Raporti i Misionit të Reagimit të Shpejtë për Lirinë e Mediave, 26 prill 2021, në: <https://www.article19.org/wp-content/uploads/2021/04/MFRR-Serbia-mission-report.pdf>; Grupi Punues i Këshillit të Drejtave të Njeriut për Rishikimin Periodik Universal Sesioni i dyzetë e tretë 1–12 maj 2023, Mali i Zi, Përmbledhja e informacionit të përgatitur nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në: <https://www.ohchr.org/en/hr-trupa/upr/me-index>; ECPMF, Presioni politik mbi gazetarët rrezikon të minojë progresin e lirisë së medias në Kosovë, 17 nëntor 2022, në: <https://www.ecpmf.eu/political-pressure-on-journalists-risks-undermining-media-freedom-progress-in-kosov/>

për të formuar një degë të Qendrës PEN të Bosnjë-Hercegovinës në Republikën Serbe”. Ajo shtoi më tej: “Këto presione politike filluan me ndarjen ideologjike dhe përçarjen mes anëtarëve të Qendrës PEN në Bosnjë-Hercegovinë, si dhe konfliktet individuale brenda anëtarësisë të shkaktuara nga pozicione të ndryshme politike, por edhe për shkak të qëllimit që Qendra të vihet nën kontrollin politik të partisë në pushtet. Ishte vështirë t’u rezistohet këtyre presioneve”.

Gojko Bozoviq, kryeredaktor dhe drejtor i shtëpisë botuese “Arhipelag” në Serbi, dhe nënkryetar i PEN-it serb, identifikoi disa lloje të presionit të drejtpërdrejtë ndaj shkrimtarëve në vend:

- Mohimi i njohjeve shoqërore dhe artistike.
- Refuzimi ose kufizimi i financimit të projektit.
- Mohimi ose kufizimi i platformave mediatike.
- Fushata shpifëse në tabloidet pro-qeveritare.
- Mungesa e vullnetit politik për të hetuar kërcënimet.

Shkrimtari, gazetari dhe kolumnisti nga Mali i Zi, Gjorgje Shçepoviq tregoi përvojën e tij personale dhe të kolegëve të tij të punës: **“Unë punoj si autor televiziv dhe kolumnist në Televizionin ‘Gradska’ në Podgoricë, kështu që mund të flas për presione dhe kërcënime. Që nga themelimi i saj, ‘Gradska TV’ ka qenë e ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe presioneve të vazhdueshme. Këto kërcënime kanë ardhur edhe nga kryeministri Dritan Abazoviq. Ai ka kërcënuar se ‘Gradska TV’ nuk do ta vazhdonte më punën. Janë kërcënuar gazetarët. Ndaj disa prej tyre janë ngritur kallëzime penale. Qëllimi ka qenë frikësimi dhe censura. Është e qartë se çdo kërcënim është i inkurajuar nga deklaratat e përfaqësuesve më të lartë të qeverisë. Institucionet në Mal të Zi nuk kanë bërë asgjë, sepse janë nën kontroll të plotë të regjimit aktual”.**

Aleksandar Radoman është profesor në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Malazeze si dhe kolumnist. Ai ka shpjeguar se si është shënjestruar rregullisht me gjuhë të urrejtjes. **“Si kolumnist në portale malazeze, shpesh u ekspozohem komenteve negative në media dhe në rrjete sociale. Kjo ndodhë kryesisht nga i njëjti grup njerëzish që janë të djathtë dhe aktiviteti i tyre politik konsiston në promovimin e ksenofobisë, racizmit kulturor, islamofobisë etj. Dhe këto janë shpesh temat e kolumneve që i botoj”.**

Aleksandra Krstiq, profesoreshë në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Beogradit, Serbi, shpjegoi se gazetarët dhe redaktorët ndonjëherë vendosnin të ndryshonin raportimin si rezultat i kërcënimeve, fyerjeve dhe frikësimëve. Ata nuk donin të

vazhdonin t’u ekspozoheshin sulmeve, pasi mekanizmat ekzistues të mbrojtjes dhe mbështetjes institucionale ishin të dobëta.

Kryeredaktori i një shtëpie botuese nga Beogradi, Serbi, tha se duhet bërë dallim midis shkrimtarëve që janë të angazhuar në shoqëri dhe atyre që nuk janë. **“Mendoj se është e nevojshme të bëhet dallimi mes një shkrimtari dhe një aktivisti apo kolumnisti, gazetarëve që janë gjithashtu shkrimtarë, apo komentuesve televizivë dhe nikoqirëve të emisioneve që janë shkrimtarë. Ata nuk janë vetëm shkrimtarë, por angazhohen edhe në veprimtari të tjera publike. Ka një shkallë rezistence ndaj personazheve publike që punojnë intensivisht në media. Kjo varet nga sasia dhe fuqia e ndikimit publik. Skena mediatike është e ndarë dhe secila palë ka mediat e veta”.**

Disa të intervistuar theksuan edhe një lloj presioni të dallueshëm: pamundësinë e promovimit të librave të tyre të rinj. Ata thanë se qendrat kulturore, bibliotekat dhe platformat tjera janë përmbajtur nga organizimi i promovimeve të librave për shkak se janë frikësuar që pikëpamjet e shkrimtarëve të pavarur do të mund të shkaktonin ndarje të mëdha në sferën publike. Shkrimtari dhe gazetari nga Serbia Marko Vidojkoviq tha se ishte e pamundur që një figurë mendjehapur dhe e pavarur si vetë ai të jepte intervistë për një media që lexohet apo shikohet nga shumë njerëz. Shkrimtarë të tillë promovojnë librat e tyre në platformat e mediave sociale, gjë që ua vështirëson mundësinë për të shitur punën e tyre.

GJUHA E URREJTJES DHE FUSHATAT SHPIFËSE

Shkrimtari dhe gazetari, Marko Vidojkoviq, u zhvendos nga Serbia në shkurt të vitit 2023 për shkak të shqetësimit për sigurinë e tij dhe të familjes së tij. Kërcënimet me vdekje ndaj tij u intensivikuan pas botimit të romanit më të shitur “*Djubre*” (Bërlloku), në shtator të vitit 2020. Vidojkoviq raportoi se kishte marrë mbi 50 kërcënime me vdekje më 2021 dhe 2022, që rezultuan me vetëm dy ndjekje penale dhe dënime. Vidojkoviq, i njohur për qëndrimin e tij kritik ndaj autoriteteve serbe, raportoi se ishte njollosur publikisht në disa raste nga politikanët e partisë në pushtet në Serbi, përfshirë aty edhe presidentin serb Aleksandar Vuçiq dhe kryeministren Ana Brnabiq, dhe se rregullisht ishte njollosur nga mediat pro-qeveritare. Kërcënimet e vazhdueshme kundër Vidojkoviqit erdhën pasi kishin nisur sulmet e pandërprera kundër shkrimtarëve dhe gazetarëve në Serbi, të orkestruara nga akterë shtetërorë dhe joshetërorë, me synim që t’ua ndalin punën dhe raportimin kritik. **“Kam marrë shumë kërcënime dhe ofendime. Do të flas vetëm për tre vitet e fundit – nga protestat 1 në 5 milionë , ku**

mbajta fjalime në rreth njëzet qytete.⁷⁰ Në atë kohë isha një nga prezantuesit e emisionit ‘Dobar loš zao’ (I miri, i keqi dhe i shëmtuari) me kolegun tim Nenad Kulaçin, shkrimtar dhe kolumnist në ‘BUKA’ – portal online nga Banjalluka”, ka thënë Vidojkoviq.

“Filloi në vitin 2019. Çdo gjë e vogël dhe çdo detaj provokoi reagime dhe sulme kundër meje. Në një episod të ‘Dobar loš zao’ thashë se doktorët e shkencave dhe intelektualët (përveç Vojsllav Sheshelit) nuk shkuan në fushëbetejë, por njerëzit e thjeshtë po. Tabloidit ‘Srpski telegraf’ raportoi se kam fyer veteranët serbë. Gazetarët e kësaj media ftuan kriminelët e dënuar të luftës ta komentojnë deklaratën time. Në atë kohë isha drejtues i një emisioni në ‘TV Šabac’. Është një televizion lokal dhe nuk ka shtrirje të gjerë. Në një protestë në Beograd, fola për sistemin ligjor dhe të gjithë më sulmuan në mediat kryesore. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq iu bashkua sulmit. Ai tha se sapo kam kaluar pranë Fakultetit të Drejtësisë, ndoshta vetëm për të ngrënë një burger. Kur e kuptoi që unë kam diplomë në drejtësi, tha se isha student shumë më i keq se ai. Që nga momenti kur presidenti Vuçiq më përmendi mua personalisht, gjithçka u përkeqësua”.

Veran Matiq kujtoi gjithashtu një incident që përfshinte shkrimtarin Dragan Velikiq, i cili përjetoi një fushatë shpifjeje të nisur nga tabloidet pro-qeveritare. Djali i tij, mjek në Austri, u akuzua rrejshëm se kishte helmuar kolegët e tij. Historia është përdorur në tabloide kundër Dragan Velikiqit. Pas lirimit të djalit të tij, Velikiq synonte të padiste tabloidët, por hoqi dorë pasi tarifat gjyqësore do të ishin shumë të larta dhe procedurat ligjore do të ishin të gjata dhe të pasigurta.

Igor Shtiks tha: **“Shkrimtarët bëhen objektiva të gjuhës së urrejtjes nëse vënë në dyshim një (ose të gjitha) nga sa vijon: mitet kombëtare, ngjarjet nga e kaluara e afërt dhe ata në pushtet. Qëllimi kryesor i shënjestrimit të njerëzve me gjuhë urrejtjeje dhe denigrim personal është depersonalizimi i individëve aktivë, në mënyrë që dhuna ndaj tyre të normalizohet”.**

Selvedin Avdiq nga revista “*Žurnal*” në Bosnjë-Hercegovinë është vënë shpesh në shënjestër të gazetarëve të tabloidëve pro-qeveritare dhe në platformat e mediave sociale, të cilët nuk pajtohen me përmbajtjen dhe politikën editoriale të recistës. **“Kam frikë se kam përsëritur të njëjtat gjëra dhe kam shkruar të njëjtat tekste për dekada. Gjithmonë më kanë sulmuar, më kanë shpallur agjent të Fondacionit Soros, tradhtar dhe aktualisht më quajnë anëtar i Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale. Më parë, fushatat kundër meje patën nisur nga revista ‘Ljiljan’ dhe gazeta e përditshme ‘Dnevni avaz’. Kohëve të fundit fushata kundër meje nisën gazetarët e revistave ‘Stav’ dhe**

‘Saff’. Njerëzit që janë të afërt me qendra të caktuara partiake më shajnë në rrjetet sociale. Nuk mendoj se jam i sulmuar për shkak të përmbajtjes së librave të mi, ndonëse edhe ato përmbajnë kritika ndaj shoqërisë. Ma merr mendja që ato nuk i kanë lexuar”. Revistat “*Stav*” dhe “*Saff*” janë media nacionaliste boshnjake që janë afër partive boshnjake të krahut të djathtë, të cilat rregullisht bëjnë fushata shpifëse kundër atyre që mendojnë ndryshe. Të dyja revistat kanë një numër të konsiderueshëm ndjekësish, kështu që fushatat e shpifjeve përhapën në platformat e mediave sociale.

Profesori dhe kolumnisti Aleksandar Radoman nga Mali i Zi ndau një shembull të shënjestrimit të shkrimtarëve nga ana e politikanëve dhe zyrtarëve publikë. **“Kryeministri Dritan Abazoviq e përmendi në kontekst negativ Qendrën malazeze PEN në Parlamentin e Malit të Zi. Ai tregoi një fotografi të shkrimtarit Milorad Popoviq dhe e lidhi atë me mjedisin kriminal, duke e akuzuar për ekstremizëm dhe përçarje në shoqëri. Ai nuk kishte prova për këtë. Abazoviq stigmatizoi gjithashtu shkrimtarin Andrej Nikolaidis dhe tha se ‘ka diçka fashiste në të’”. Gjorgje Shçepoviq po ashtu kujtoi incidentin. “Abazoviq më pas listoi edhe emrat e gazetarëve dhe shkrimtarëve që janë të pabindur dhe që nuk janë nën kontrollin e tij”.**

Marko Vidojkoviq thotë se në gjysmën e dytë të vitit 2020 u largua nga “TV Šabac” dhe filloi të punojë me portalin “Nova RS”. **“Në atë kohë u botua romani im ‘Dubre’ (Bërlloku). Në roman shkruaj për regjimin dhe për këto kohë të tmerrshme. Pastaj sulmet u intensivikuan. Na quanin me emra të tmerrshëm - na quanin qimëdredhur manjatësh etj”.** Vidojkoviq theksoi se askush në “United media”, kompania mëmë e portalit “Nova RS”, nuk i bëri presion atij dhe Nenad Kulashinit për shkak të përmbajtjes së emisionit dhe mysafirëve që ftuan. **“Në nëntor të vitit 2020, filluam të transmetojmë ‘Dobar loš zao’ (I miri, i keqi dhe i shëmtuari) në TV dhe kjo shkaktoi sulme nga mediat e regjimit për gjithçka që publikuam – absolutisht edhe për më të voglën gjë. Në pranverën e vitit 2021, u shitën 20,000 kopje të romanit tim. Dhe unë dhe gruaja ime u bëmë viktima të një sulmi nga tabloidit ‘Objektiv’”. Vidojkoviq dhe gruaja e tij paditën tabloidin pro-qeveritar “Objektiv” dhe fituan dëmshpërblim në gjykatë, por nuk ishin të kënaqur me rezultatin, kështu që e apelian. “Ka pasur ndikim të madh te gruaja ime dhe te unë. Ishte kjo hera e parë që ajo po sulmohej drejtpërdrejt. Në qershor 2021, sulmet u përshkallëzuan. Verdikti ndaj kriminelit Ratko Mlladiq u vërtetua dhe e përkrahëm këtë në emision. Mora një porosi në Instagram – ‘E di ku jeton, do të ther, do të bëj copa’. Pati reagime nga OSBE-ja, Reporterët pa Kufij, PEN-i serb, por ishte një gjueti e hapur shtrigash për mua. Aleksandar Shapiq bëri një kërcënim publik për mua dhe Nenad Kulashin. Ai tha se do të na shqyente zemrat nëse do të na takonte**

⁷⁰ “Një në pesë milionë” është një shoqatë që organizoi protesta antiqeveritare në Serbi në vitin 2020.

në rrugë, për diçka që ne as nuk e kishim thënë. Këtë e ka deklaruar në 'TV Pink'. Është ky një televizion me frekuencë kombëtare. Ne bëmë kallëzim penal kundër Shapiqit, por ai menjëherë u hodh poshtë nga prokuroria. Na thanë se nuk ka qenë serioze, se ishte thënë me kusht dhe se ai vetëm po bënte shaka. Pas kësaj, Shapiq ngriti tre padi 'Dobar loš zao' dhe për përmbajtjen e kolumneve tona - dy kundër Nenad Kulashinit dhe një kundër meje. Aktualisht, kam tre padi nga ai - dy nga koha kur ai u bë nënkryetar i partisë SNS dhe i treti është nga koha kur ai u bë kryetar i Komunës së Beogradit. Ai e keqpërdor pozitën e vet për të gjeneruar konflikte me gazetarët dhe aktivistët".

Aleksandar Shapiq nuk është i vetmi politikan që kërcënoi Marko Vidojkoviçin. *"Ish-ministri i Policisë së Serbisë, Aleksandar Vulin, më kërcënoi përmes 'TV Pink' dhe mediave të tjera pro regjimit. Ai më kërcënoi me arrestim për kritikën ndaj autoriteteve dhe tha se e meritoj secilin kërcënim që kam marrë. Kryeministrja Ana Brnabiç shkroi një letër të hapur kundër meje. Që nga shtatori i vitit 2021, emisioni ynë nuk transmetohet më në televizion. Presioni mbi "United media" ishte i madh. Na thanë se emisioni ynë nuk ishte në përputhje me konceptin e ri programor. Tani, produksioni televiziv e xhiron emisionin tonë, por e transmetojmë në portal dhe në kanal në YouTube. Ne jemi televizion gueril, dhe kjo është mënyra e vetme për të thënë atë që mendojmë. Sulmet nuk u ndalën, ato u intensifikuan".* Duke marrë parasysh se jeta e Marko Vidojkoviçit ishte nën kërcënim serioz, PEN International ndihmoi evakuimin dhe rilokimin e tij të menjëhershëm në vitin 2023.

SULME VERBALE DHE KËRCËNIMET ONLINE: SHKREPËS PËR DHUNË FIZIKE?

Sulmet verbale kundër shkrimtarëve dhe gazetarëve janë të zakonshme në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi, veçanërisht në internet. Edhe pse sulmet fizike ndodhin rrallë, ata që janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve verbale, ngacmimeve dhe frikësimeve jetojnë në frikë konstante që dhuna mund të përshkallëzojë.

Andrea Leshiq-Thomas, profesor në Fakultetin Filozofik në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, tha se ngacmimet në internet dhe fushatat e shpifjeve përbëjnë po ashtu formë serioze të dhunës dhe se efektet e tyre nuk duhet të reduktohen në mundësinë e përshkallëzimit fizik. Ata që vihen në mund të ndihen shpesh sikur pothuajse janë rrahur fizikisht dhe efektet psikologjike zgjasin për një kohë të gjatë.

Selvedin Avdiq, për ata të etiketuar si "tradhtarë" apo "agjentë të huaj", tha: *"Ka njerëz nervozë. Ngjarjet e fundit në Banjallukë, kur u sulmuan gazetarët e aktivistët dhe u rrënuan objektet e organizatave joqeveritare, na tregojnë se situata do të bëhet edhe më e ndërlikuar.⁷¹ Paralajmërimi i ligjeve të reja dhe kufizuese për mediat dhe organizatat joqeveritare në Republikën Serbe do të rezultojë me heshtje të të gjithë atyre që kritikojnë qeverinë dhe regjimin".*

Sanja Orlandiq, anëtare e Qendrës Malazeze PEN, vuri në dukje problemin e dhunës në hapësirat publike. *"Ngacmimi në rrjetet sociale dhe mediat e njëanshme është një problem jashtëzakonisht i madh. Autorët e faqeve të shumta meme që nisin fushata të tilla janë nën mbrojtjen e partive politike. Edhe pse përhapin gjuhë të urrejtjes, autorët e atyre faqeve janë të mbrojtur, ndaj tyre nuk ka sanksione dhe nuk ka reagime adekuate të organeve kompetente shtetërore".*

Shkrimtari Bojan Krivokapiq nga Serbia argumentoi se serioziteti i dhunës në internet është nënvlerësuar. *"Fushatat në media sociale mund të jenë shumë më të rrezikshme sesa mendojmë. Njëra nga pasojat e tyre mund të jetë dhuna fizike. Por ka edhe pasoja në gjendjen psikologjike të personit që sulmohet".*

Veran Matiq tha: *"Përveç vrasjes së gazetarëve në të kaluarën e afërt, kemi pasur atentat ndaj Dejan Anastasijeviqit, gazetar i së përjavshmes 'Vreme'. Ata vendosën bombë në dritaren e tij sepse ai po hetonte krimet e luftës dhe ishte dëshmitar në Hagë. Së fundmi, shtëpisë së një gazetari i është vënë*

zjarri, e para kësaj redaktori i tij ishte rrahur. Është shumë e qartë se ka ndërlidhje mes kërcënimeve përmes mediave dhe rrjeteve sociale dhe dhunës".

Ferida Durakoviç shtoi: *"Këto fushata kanë ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen materiale të shkrimtarëve të sulmuar. Jemi të vetëdijshëm, veçanërisht ne në këto shoqëri, se kjo lloj dhune verbale mund të çojë lehtësisht në dhunë fizike. Dënimi i gjuhës së urrejtjes dhe sanksionimi i ligjor i gjuhës së urrejtjes janë hapa shumë të rëndësishëm për ta parandaluar dhunën e mundshme".*

FAKTORËT SOCIO-EKONOMIKË BREJTËS TË TË SHPREHURIT

Të gjithë shkrimtarët dhe ekspertët e intervistuar për këtë raport argumentuan se shkrimtarët nuk mund të sigurojnë jetesën ekskluzivisht nga shkrimi i librave. Atyre iu duhet të marrin role të tjera për t'ia dalë mbanë. Shkrimtarët priren të punojnë për disa media në të njëjtën kohë. Meqenëse shumë media përballen me probleme financiare, kolumnistët paguhën pak. Mungesa e kompensimit adekuat monetar për punën si dhe pagesat e parregullta, nënkuptojnë se ndikimi i këtyre kërcënimeve është më i dëmshëm dhe në mënyrë joproporcionale ndikon në mundësinë e tyre për të vazhduar shkrimin.

Igor Shtiks argumentoi se shkrimtarët dhe kolumnistët janë në pozitë të vështirë socio-ekonomike. *"Shkrimtarët nuk janë më thjesht shkrimtarë. Shumica prej tyre, për të mbijetuar, bëjnë punë të tjera në sferën publike, kryesisht duke shkruar kolumne në ueb-portale. Pikërisht këtu statusi socio-ekonomik bëhet i rëndësishëm pasi kur shkrimtarët angazhohen publikisht, ata bëhen objektiva të dhunës nëse rrezikojnë pozicionet e caktuara dominuese ideologjike dhe/ose interesat private në shoqëritë e tyre".*

Ferida Durakoviç tha se shkrimtarët janë në pozitë veçanërisht të pafavorshme. *"Si poete kam paguar shumë për lirinë time. Dhe kur isha e re në ish-Jugosllavi, pastaj gjatë luftës, e sidomos pas luftës, kur e kuptova (ndoshta shumë vonë) se artistët shërbejnë për polarizimin politik dhe jo për afirmimin e vendeve të tyre".* Ajo theksoi se ka shkruar artikuj gazetash, ese dhe kolumne, libra me poezi dhe prozë. Tani ajo shkruan kolumne për një portal online. *"Askush nuk e ka ndryshuar përmbajtjen time apo më ka penguar të publikoja përmbajtje të caktuara. Ndonjëherë nuk donin të mi botonin esetë apo kolumnet, por duke qenë person këmbëngulës, gjeja media të tjera që do ta bënin këtë".*

Lejla Kalamujiq nuk është e punësuar si kolumniste dhe nuk shkruan për media. Ajo beson se problemi më i madh në letërsinë vendase për shumicën e shkrimtarëve është se ata nuk mund të sigurojnë jetesën nga puna e tyre letrare. *"Shkrimtarët kanë punë të tjera ose janë të përfshirë në projekte të ndryshme jashtë vendit. Vitet e fundit kam kaluar shumë kohë në programe të ndryshme rezidenciale të financuara nga BE-ja. Ne nuk mund t'i mbulojmë shpenzimet e jetesës nga puna jonë letrare në Bosnjë-Hercegovinë. Mendoj se ata autorë që shkruajnë për gazeta apo portale janë nën presionin më të madh. Ata me siguri se janë të ekspozuar ndaj shantazheve të ndryshme, refuzimeve të bashkëpunimit, problemeve me tarifën".*

Selvedin Avdiq tha se situata në Bosnjë-Hercegovinë është jashtëzakonisht komplekse dhe se njerëzit që nuk kanë jetuar atje do ta kishin të vështirë ta kuptonin. *"Ndonjëherë, mendoj se edhe njerëzit qëllim-mirë nuk e kuptojnë se çfarë po ndodh në Bosnjë-Hercegovinë. Shumë njerëz i shikojnë gjërat përmes lentës bardh e zi. Disa shkrimtarë nga Bosnjë-Hercegovina, të cilët janë shumë të afërt me strukturat politike, janë shpallur disidentë dhe kritikë të shoqërisë në vende të tjera. Ka shumë hipokrizi, gënjeshtria dhe abuzime".*

Kryetari i Qendrës PEN në Kosovë, Ibrahim Berisha, tha se institucionet shtetërore në Kosovë nuk kanë siguruar mjete të mjaftueshme për kulturën. Ai shpjegoi tutje se shkrimtarët priren të jenë në pozitë të vështirë financiare. *"Pozita shoqërore e shkrimtarëve është shumë e keqe. Disa shkrimtarë, anëtarë të Qendrës PEN marrin pension mujor prej 100 €. Këta njerëz kanë punuar për 40 vjet si shkrimtarë dhe gazetarë".*

71 Radio Evropa e Lirë, Aktivistët e të drejtave të njeriut të lënduar pas ndalimit të eventeve LGBT në Banjallukë, 19 mars 2023, e gjeni në: <https://www.rferl.org/a/bosnia-rights-activist-injured-banja-luka-lgbt-ban/32325055.html>

EFEKTE RRËNQETHËSE: SHTYTJA DREJT VETËCENSURËS

Pothuajse të gjithë shkrimtarët dhe ekspertët e intervistuar ranë dakord se situata sfiduese mediatike dhe politike në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi ka ndikuar fuqishëm në punën e shkrimtarëve dhe të kolumnistëve.

Shkrimtarët e angazhuar janë të vetëdijshëm se aktivitetet e tyre janë të dukshme për të gjithë dhe se një fjali e paqartë mund të shkaktojë ngacmime, kërcënime dhe frikësim. Shkrimtarët që përqendrohen në çështjet që lidhen me politikën, luftërat, krimet e luftës, korrupsionin, padrejtësinë dhe pabarazinë sociale, të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave, kanë raportuar se janë ekspozuar ndaj shpifjeve mediatike, abuzimeve në internet dhe gënjeshtërave e insinuatave tinëzare, të vazhdueshme dhe të mëdha. Kapitujt e mëparshëm vunë në pah mungesën e mbrojtjes ligjore dhe reagimet joadekuade të institucioneve si dhe theksuan se si çdokush mund të përhapë gjuhë të urrejtjes pa u ndëshkuar.

Censura është shumë e shprehur në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi. Pronarët dhe redaktorët e mediave shpesh nuk duan të publikojnë tekste nga frika se mund të krijojnë probleme. Ata kryesisht e justifikojnë qëndrimin e tyre para shkrimtarëve dhe gazetarëve me shpjegime të vakëta, duke argumentuar se lexuesit nuk do të interesoheshin për tema të tilla.

E gjithë kjo e forcon autocensurën, për të cilën shumë shkrimtarë thanë se ishte gjëja më e dëmshme për punën e tyre dhe që në masë të madhe ka kufizuar lirinë e tyre për të shkruar.

Igor Shtiks tha: *“Në përgjithësi, në të gjithë rajonin, ekziston një tendencë për të krijuar një atmosferë në të cilën ka një porosi të qartë për këdo që del publikisht me ide dhe zëra kundërshtues se ai/ajo mund të përballë me pasoja. Situata është duke u përkeqësuar në krahasim me vitet e kaluara, veçanërisht në Serbi. Për shembull, shfaqja ime ‘Elijahova Stolica’, e cila në vitin 2010 ishte nëpër teatro dhe vinte në dyshim ngjarjet nga e kaluara e afërt, sot zor se do të mund të gjente vend aty. Oliver Frliq, për shembull, nuk do të pranohej më në teatrot në Serbi”.*⁷²

Gojko Bozhoviq argumentoi se në sistemet populiste dhe hibride, shkrimtarët janë në pozitë veçanërisht të vështirë. Kjo sugjeron se zgjedhje më pragmatike është mos-angazhimi në vend të mbajtjes së qëndrimeve dhe opinioneve kritike, duke ulur kështu numrin e shkrimtarëve dhe intelektualëve të angazhuar. *“Mendimi kritik është i mundur në margjinat e publikut, në një numër shumë të vogël mediash, më shpesh në ato që nuk kanë shumë ndikim dhe nuk janë të qasshme për një numër të madh njerëzish. Kjo çon porosinë se mendimi kritik nuk është i dëshirueshëm dhe popullor, se angazhimi publik mund të jetë shkak i fushatave të tabloideve ose presionit të drejtpërdrejtë”.*

Disa bashkëbisedues shtuan se disa shkrimtarë vendosën të ndjekin linjën zyrtare si mënyrë e sigurt për të fituar para dhe për të bërë jetë komode. Bojan Krivokapiq theksoi se disa shkrimtarë iu dorëzuan shantazhit dhe censurës. *“Kur flasim për pranimin e censurës ose autocensurës, duhet të jemi të vetëdijshëm edhe për pozicionin e personit që pajtohet me të. Shumë shkrimtarë dhe autorë nuk kanë privilegjin dhe as forcën psikofizike për të qenë konsistent në pikëpamjet e tyre. Me moshë, e pata kuptuar se dikush thjesht nuk mundet. Dikur mendoja se duhet të jesh radikal! Tani mendoj se secili duhet t’i vlerësojë mundësitë e veta dhe ta bëjë më të mirën brenda tyre”.*

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Siç dokumentohet në këtë raport, shkrimtarët e pavarur, gazetarët, aktivistët e shoqërisë civile dhe individë të tjerë të angazhuar në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi përballen me një sërë kërcënimesh dhe sulmesh të drejtpërdrejta, që synojnë t’ua mbyllin gojën. Si rezultat, hapësira për lirinë e shprehjes po zvogëlohet, duke prekur njësoj mediat, shkrimtarët dhe shoqërinë civile.

PEN International u bën thirrje autoriteteve të Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë që ta mbështesin plotësisht të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të krijojnë një mjedis në të cilin mund të zhvillohet debati i lirë publik. Në veçanti, PEN International u bën thirrje autoriteteve që:

- T’i japin fund menjëherë glorifikimit të kriminelëve të luftës, narrativave revizioniste dhe përdorimit të gjuhës së urrejtjes, si dhe mohimit të krimeve të luftës dhe gjenocidit.
- T’i dënojnë publikisht, pa mëdyshje dhe sistematikisht të gjitha aktet e dhunës dhe sulmet që kanë në shënjestër shkrimtarët, gazetarët dhe aktivistët.
- Të sigurojnë hetime të paanshme, të menjëhershme, të plota, të pavarura dhe efektive policore për të gjitha krimet e raportuara kundër shkrimtarëve dhe që përgjegjësit të japin llogari. Të dedikojnë resurset nevojshme për të hetuar dhe ndjekur penalisht sulmet.
- Të përforcojnë sistemin e mbledhjes, analizimit dhe raportimit të të dhënave kombëtare për sulmet kundër shkrimtarëve dhe gazetarëve.
- Të krijojnë mekanizma për mbrojtjen e gazetarëve aty ku nevojitet dhe të sigurojnë që mekanizmat ekzistues të jenë efektivë në praktikë.
- Të harmonizohen plotësisht ligjet, politikat dhe praktikat që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave me detyrimet dhe zotimet e tyre ndërkombëtare.
- Të gjitha përpjekjet për ta rregulluar gjuhën e urrejtjes apo të çfarëdo nxitjeje tjetër të diskriminimit apo dhunës duhet ta mbrojnë plotësisht të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të mos përdoren për të shtypur format paqësore të shprehjes së kundërshtimit.
- Ta krijojnë një Regjistër të Mediave me të gjithë indikatorët e duhur medialë për të rritur transparencën e pronësisë së mediave dhe për të siguruar që personat e shënjestruar ta kenë në dispozicion informacionin e nevojshëm për veprime të mundshme ligjore.

Rekomandime për shkrimtarët, gazetarët dhe individët dhe grupet e tjera të angazhuara publikisht në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi:

- Ta rrisin solidaritetin mes shkrimtarëve dhe gazetarëve dhe ta forcojnë bashkëpunimin ndërmjet asociacioneve të gazetarëve dhe të shkrimtarëve, duke përfshirë aktivitetet mbrojtëse dhe informuese. Bashkëpunimi ndërsektorial është i domosdoshëm, meqë shkrimtarët shpesh punojnë si gazetarë.
- Ta ngrënë ndërgjegjësimin e publikut për një sërë sfidash me të cilat përballen, mes tjerash edhe përmes intervistave, promovimeve të librave dhe ngjarjeve të tjera publike, si dhe përmes fushatave të dedikuara rasteve të shkrimtarëve të persektuar. Asociacionet e gazetarëve dhe të shkrimtarëve të llobojnë tek akterët ndërkombëtarë në nivel kombëtar dhe global.
- Të vendosin apo përforcojnë komunikimin me platformat online, për t’i raportuar në mënyrë më efektive rastet e fushatave të ngacmimeve dhe shpifjeve në internet.

Rekomandime për organizatat ndërkombëtare dhe palët e interesuara:

- Në të gjitha bisedimet dypalëshe dhe shumëpalëshe, t’ua rikujtojnë autoriteteve përkatëse kombëtare obligimin e tyre kombëtar dhe ndërkombëtar që ta mbështesin të drejtën e lirisë së shprehjes, si dhe t’u dërgojnë mesazh të qartë se presioni dhe dhuna ndaj shkrimtarëve, gazetarëve, aktivistëve dhe individëve të tjerë të angazhuar nuk do të tolerohet.
- Asociacionet ndërkombëtare të mediave dhe të shkrimtarëve duhet të përipiqen që ta nxjerrin në pah gjendjen e rëndë të shkrimtarëve dhe të gazetarëve specifikë, pasi historitë personale bëjnë jehonë më të veçantë.
- Ta rrisin mbështetjen për mediat e pavarura, shkrimtarët dhe gazetarët, duke dënuar sistematikisht dhe publikisht të gjitha incidentet e ngacmimit dhe frikësimit, si dhe duke dedikuar resurse të nevojshme për të mbështetur punën e tyre.
- Ta përforcojnë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në rastet e dhunës kundër shkrimtarëve dhe gazetarëve, për shkak se ata që janë përgjegjës për dezinformim dhe shpifje shpesh banojnë jashtë vendit.
- T’u sigurohet shkrimtarëve, gazetarëve dhe OJQ-ve mbështetje dhe ndihmë, në mënyrë që ata të mund ta përballojnë financiarisht marrjen e masave ligjore kur është e nevojshme ose ta mbrojnë veten kur përballen me SLAPP.

⁷² Oliver Frliq është regjisor teatri i cili aktualisht jeton në Kroaci. Dramat e tij trajtojnë tema të shumta tabu të shoqërive post-jugosllave.



pen-international.org